




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. 51 prot.

Durrës, më 16.01.2023



KONTROLLI SHTETËROR PORTUAL

# PLAN PUNE

PRANOI

ZV/DREJTOR I PRËGJITHSHËM DHE KAPITEN I PORTEVE

TOMOR HARIZI

JANAR 2023

## **Hyrje!**

Kontrolli Shtetëror Portual ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin nr.9251,datë 08.07.2004” Kodi Detar I Republikës së Shqipërisë”Neni 34, Ligjit Nr 10109,datë 02.04.2009” Per Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë”,neni 10,Ligjin nr.9852,datë 26.12.2007 “Per Aderimin e Shqipërisë në Memorandumin e Mirkuptimit per Kontrollin Shtetëror Portual”,VKM nr 13,datë11.01.2017 për Miratimin e Rregullores “ Për Kontrollin Shtetëror Portual në Republikën e Shqipërisë”,si dhe Urdhrin nr.883,datë 21.12.2018.

-Sektori i Kontrollit Shtetëror Portual nëpërmjet inspektorëve dhe specialistëve që ka në organikë ka një përgjegjësi të madhe dhe njëkohësisht luan një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin në kohë të reziqeve që vijnë nga mjetet detare të amortizuara , por edhe nga mjete më të reja, të cilat kanë destinacion radat dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë duke mundësuar parandalimin e incidenteve dhe aksidenteve shkaktuar prej tyre dhe rrjedhimisht parandalon dhe mbron mjedisin detar nga ndotjet e vajit , naftës apo agjentë të tjerë ndotës.

-Aktiviteti dhe veprimtaria e inspektorëve dhe specialistëve si pjesë e Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual përgjithësisht është e pa planifikueshme dhe nuk mund të kryhet duke u bazuar vetëm në programe të paramenduara dhe të planifikuara, për vetë faktin se kjo veprimtari ndërvarret nga aktiviteti ekonomik dhe tregëtar i cili zhvillohet në portet e hapura të RSH nëpërmjet transportit detar të sasive dhe llojeve të ndryshme të mallrave.

## PLANI I PUNES

### PËR PERIUDHEN JANAR-DHJETOR 2023

#### ➤ Aktiviteti i punës së sektorit të KSHP konsiston në:

- a. Grumbullimin ditor të informacioneve të ndryshme nga burime të alternative mbi mjetet detare që kanë destinacion portet e hapura dhe radat e Republikës së Shqipërisë.
- b. Analizimin e informacioneve të grumbulluara dhe përcaktimin e riskut të këtyre mjeteve.
- c. Përcaktimin e mjeteve detare për inspektim sipas prioritetit të tyre, bazuar tek risku që ato paraqesin.
- d. Përgatitja e planit të punës për inspektim si dhe përcaktimi i inspektorëve /specialistëve që do inspektojnë anijet dhe miratimi nga epërori.
- e. Kryerjen e inspektimeve në anijet e planifikuara.
- f. Lëshimin e raportit të inspektimit.
- g. Grumbullimin dhe menaxhimin e dokumentacioneve të mara në anijet e inspektuara.
- h. Mbajtjen e evidencave mujore e vjetore për anijet e inspektuara.
- i. Kryerjen e veprimeve të mëtejshme në rastin e bllokimit dhe zhblokimit të anijeve bazuar në parashikimet e rregullores.
- j. Planifikimin e inspektimeve vjetore dhe sezonale në anijet e pasagjerëve që operojnë në linjë të rregullt ndërkombëtare për transport pasagjerësh dhe mjetes.
- k. Përgatitja e informacionit për MIE cdo 3 muaj.
- l. **Paraqitja e Objektivat per vitin 2023 se bashku me planet e punes,**
- m. Paraqitjen e informacioneve 6- mujore dhe vjetore mbi aktivitetin e Sektorit të KSHP dhe performancës së personeli të sektorit.

- n. Inspektimin e anijeve të ndryshme kur ka arsye të qarta ( në rast defektesh,keq funksionim, ndotjesh detare etj nga informacione të mara nga burime të ndryshme)
- o. Takimin mujor të punës,përgatitjen e informacionit në lidhje me performancën e personelit dhe paraqitja e tij te epërori.

Veprimtaria e Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual bazohet në kontratën e performancës të miratuar nga Drejtori I Përgjithshëm I DPD-së.

**1. Për periudhën Janar –Dhjetor 2023**,në zbatim të objektivit *Kryerja e inspektimeve në të gjitha anijet me flamur të huaj me nivel të lartë risk*,Sektori I KSHP do të analizojë në mënyrë të hollësishme të dhënat e më poshtëme:

a) **Grumbullimi ditor i informacioneve të ndryshme nga burime alternative mbi mjetet detare që kanë destinacion portet e hapura dhe radat e Republikës së Shqipërisë.**

-Në zbatim të kësaj pike, ç`do ditë nga e Hëna në të Premte ora 08<sup>30</sup> deri 09<sup>30</sup> do të bëhet takim punë në zyrën e KSHP me pjesëmarrjen e shefit të zyrës dhe të gjithë inspektorëve dhe specialistëve të portit Durrës.Në këtë takim të përditshëm pasi të meret prezenca do të diskutohet mbi situatën ditore në rada dhe portet e hapura të RSh do të grumbullohen informacione nga burime të ndryshme mbi anijet qe janë në pritje ,anijet në radë dhe port. Inspektorët e KSHP të portit Vlorë, do të dërgojnë informacion ditor me email mbi situatën detare të porteve Vlorë dhe Sarandë . Do të plotësohet check-lista bashkëngjitur.

b) **Analizimi i informacioneve të grumbulluara dhe përcaktimin e riskut të këtyre mjeteve.**

Në zbatim të kësaj pike gjatë takimit të përditshëm do të bëhet analiza e të gjithë informacionit të grumbulluar dhe do të përcaktohet risku për të gjitha anijet në porte dhe rada.Në vlerësimin e riskut,bazuar dhe në parashikimet e regullores si dhe në procedurat që ndjekin inspektorët e PSC anëtarë të MoU,do të meren në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- **Flamuri i anijes.**

Flamuri i anijes, në tabelën e parashikimit të riskut maturohet me dy pikë duke faktuar rëndësinë e tij. Përcaktimi i pozicionit të tij në tabelën e renditjes së IMO është i domosdoshëm.

- **Kompania e Menaxhimit.**

Edhe kompania e menaxhimit maturohet me një pikë për vlerësimin e riskut të anijes, prandaj del e nevojshme që të grumbullohet informacion i nevojshëm për të.

- **Mosha e anije.**

Në parashikimet e rregullores është përcaktuar që anijet më moshë më të madhe se 12 vjet të konsiderohen anije relativisht të vjetra dhe që duhet të kenë prioritet për inspektim. Mosha e anijes për vlerësimin e riskut maturohet me një pikë.

- **Lloji i ngarkesës.**

Anijet që transportojnë ngarkesa të rrezikshme, në parashikimet e rregullores, konsiderohen si anije me prioritet për tu inspektuar. Grumbullimi i informacioneve mbi llojin e ngarkesave është i rëndësishëm.

- **Inspektimi i fundit.**

Është i nevojshëm informacioni mbi inspektimin e fundit që ka kryer anije duke vlerësuar sasinë e mangësive dhe llojin e tyre. Në vlerësimin e riskut anijet me mbi kater mangësi maturohen me një pikë.

- **Regjistri i anijes (RO).**

Regjistri I anijes në maturimin e riskut të anijes maturohet me një pikë, prandaj është i nevojshëm në informacionet që grumbullohen.

o **Informacione .**

Grumbullimi dhe përditësimi i informacioneve nga burime të ndryshme si, kapiteneria, agjensitë, piloti etj, është i nevojshëm. Nëpërmjet këtyre informacioneve bëhet e mundur zbulimi i mangësive të ndryshme në anije përpara se ato të inspektohen.

-Të gjitha anijet që mbas vlerësimit që i bëhet për të përcaktuar riskun e saj grumbullojnë më shumë se pesë (5) pikë, bazuar edhe në standartet që aplikon IMO, do të konsiderohen si anije me nivel të lartë risku. Anijet me koeficient nga një deri në katër do të konsiderohen si anije me nivel standart risku dhe anijet e tjera do të konsiderohen si anije me nivel të ulët risku. Formulari mbi përcaktimin e riskut do të plotësohet elektronikisht sipas metodikës që ndjekin vendet anëtare të MoU.

**c) Përcaktimi i mjeteve detare që do të inspektohen sipas prioritetit të tyre, bazuar tek risku që ato paraqesin dhe informacioneve të mara nga burime të ndryshme.**

Në zbatim të kësaj pike do të përcaktohen anijet që janë për inspektim duke filluar nga ajo që konsiderohet me risk më të lartë, si dhe do të përcaktohet edhe lloji i inspektimit që do të kryhet bazuar në llojin e anijes. Sipas parashikimeve të rregullores së KSHP inspektimi në anije do të kryhet një herë çdo gjashtë muaj dhe jo më herët se pesë muaj, përveç rasteve kur ka arsye të qarta.

**d) Përgatitja e planit të punës për inspektim si dhe inspektorët/specialistët që do inspektojnë anijet dhe miratimi nga epërori.**

Në zbatim të kësaj pike do të përgatitet plani i punës për inspektim me pjesmarjen e dy ose më shumë inspektorëve/specialistëve, në varësi të llojit të inspektimit dhe tipit të anijes. Plan i punës përpilohet nga shefi i zyrës dhe do të miratohet nga epërori.

**e) Kryerja e inspektimeve në anijet e planifikuara.**

Në zbatim të kësaj pike, inspektorët/specialistët e nominuar në planin e punës do të kryerjnë inspektime në anijet e planifikuara, të veshur me uniformën e punës dhe duke zbatuar të gjitha parashikimet e rregullores për KSHP dhe të gjitha rregullave që ndiqen për këtë rast.

**f) Lëshimi i raportit të inspektimit.**

Në zbatim të kësaj pike, inspektorët/specialistët pasi kanë përfunduar inspektimin në anije do të lëshojnë një raport inspektimi të firmosur dhe vulosur prej tyre dhe e firmosur dhe vulosur nga kapiteni i anijes, ku të jenë përcaktuar nëse anija e inspektuar paraqet mangësi ose jo. Kopja origjinale e raportit qëndron në anije, një kopje dorzohet në sekretarinë e drejtorisë dhe një kopje në zyrën e KSHP.

**g) Grumbullimi dhe menaxhimi i dokumentacioneve të mara në anijet e inspektuara.**

Në zbatim të kësaj pike, I gjithë dokumentacioni I grumbulluar në anijet e inspektuara, përfshirë edhe raportin e inspektimit, do të ruhet në zyrën e KSHP, në dosje të vecanta, sipas datave të inspektimit.

**i) Mbajtjen e evidencave mujore e vjetore për anijet e inspektuara**

Në zbatim të kësaj pike, përgjegjësi I sektorit do të mbajë evidence mujore dhe vjetore për anijet e inspektuara, në formën e tabelave ku të paraqiten detaje kryesore mbi anijet që janë inspektuar.

**j) Kryerja e veprimeve të mëtejshme në rastin e bllokimit dhe zhbllokimit të anijeve bazuar në parashikimet e rregullores.**

Në zbatim të kësaj pike, në rastet kur një anije paraqet mangësi të mëdha dhe me vlerësimin profesional të inspektorëve/specialistët duhet të bllokohet, përgjegjësi I sektorit të KSHP plotëson urdhrin e bllokimit dhe bën njoftimet e nevojshme sipas parashikimeve të rregullores së KSHP, dhe nuk do të lejohet të largohet nga porti. Mbasi anija t'i ketë eliminuar mangësitë dhe kërkon lejimin e saj për ushtrimin e aktivitetit, do të kryhet një inspektim tjetër në anije ku do të verifikohet nëse mangësitë janë eliminuar. Nëse rezulton se këto mangësi janë eliminuar, shefi I zyrës përpilon njoftimin e zhbllokimit duke lejuar që anija të vazhdojë veprimtarinë e saj.

- 2. Për periudhën Janar –Dhjetor 2023** në zbatim të objektivit *Kryerja e inspektimeve në anijet pasagjere me flamur të huaj që prekin portet e hapura të RSh në linjë të rregullt ndërkombëtare për transport pasagjerësh dhe mjeteve.* Sektori I KSHP do të analizojë të dhënat e më poshtëme:

Në zbatim të kësaj pike, nga ana e përgjegjësit të sektorit dhe me miratimin e epërorit do të planifikojë inspektime vjetore për anijet pasagjere që operojnë në linja të rregullta ndërkombëtare për transportin e pasagjerëve dhe mjeteve. Inspektimi I anijeve të pasagjerëve do të konsistojë në dy tipe inspektimesh.

- a) Inspektimi I anijeve pasagjere për arsye licensimi. Ky inspektim do të kryhet me kërkesë të operatorëve dhe pasi mjetet që do të licensohen të kene marë formularin e

konformitetit, i cili jepet mbasi janë kontrolluar të gjitha certifikatat e dorzuara nga administratori i axhensive respektive nga zyra e sektorit të KSHP .Mbas përfundimit të inspektimit do të përpilohet një informacion I hollësishëm për anijet që inspektohen dhe do të lëshohet vërtetim mbi gjëndjen teknike të tyre,nëse ato plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

- b) Inspektimi I anijeve pasagjere gjatë sezonit veror, ku dhe fluksi I lëvisjes së pasagjerëve është I lartë.Qëllimi I këtij inspektimi do të jetë verifikimi I gjëndjes teknike të anijeve pasagjere dhe masat e mara nga stafi I tyre për përballimin e sezonit turistik me qëllim shmangien e incidenteve dhe krijimin e kushteve optimale për pasagjerët.

**3. Për periudhën Janar –Dhjetor 2023, në zbatim të objektivit *Kryerja e inspektimeve në anijet me flamur të huaj që plotësojnë kriteret për inspektim sipas parashikimeve të VKM Nr.13,datë 11.01.2017 kryesisht anijeve container dhe anijeve çisternë. Sektori I KSHP do të veprojë si më poshtë:***

Në zbatim të këtij objektivi sektori I KSHP do ti kushtojë vëmendje më të madhe anijeve konteniere dhe anijeve çisternë. Duke qënë se këto tip anijsh përpunohen shpejt, do ti kushtohet vëmendje grumbullimit të informacionit përpara se anijet të mbërrijnë në port në mënyrë që të përfitojmë në kohë për të kryer inspektin e tyre. Nga eksperiencia e vitit të kaluar anijet çisterne kanë qënë në pjesën më të madhe të rasteve të reja dhe me nivel risku të ulët, më shumë vëmendje do ti kushtohet anijeve konteniere.

**4. Për periudhën Janar –Dhjetor 2023,**

Duke qënë se anijet konteniere janë anije që përpunohen shumë shpejt dhe koha e qëndrimit të tyre në port është e shkurtër,nga ana e sektorit të KSHP inspektimi I këtyre anijeve do të ketë prioritet për tu inspektuar sa më shpejt,panvarësisht nga risku që ato paraqesin. Për anijet konteniere që kanë risk të lartë do shikohet mundësia, që edhe nëse ato përpunohen gjatë ditëve të pushimit, këto anije të inspektohen edhe gjatë këtyre ditëve.

➤ **Gjatë vitit kalendarik 2023, përgjegjësi I sektorit do të përpilojë raportet tre – mujorë të detajuara mbi aktivitetin e këtij sektori në zbatim të kontratës së përformancës që sektori i KSHP ka nënshkruar me titullarin e institucionit.**

➤ Inspektimi i anijeve të ndryshme kur ka arsye të qarta ( në rast defektesh, keq funksionim, ndotjesh detare etj nga informacione të mara nga burime të ndryshme)

Në zbatim të kësaj pike, përgjegjësi I sektorit do të organizojë grupe inspektimi,të miratuara nga epërori për të gjitha anijet që nëpërmjet informacioneve të ndryshme ,paraqesin mangësi,

pavarësisht nëse këto anije mund të kenë një raport inspektimi të vlefshëm në bord apo nuk paraqesin nivel të lartë risku.

## **OBJEKTIVAT**

- 1) Nisur nga fakti që Sektori i Kontrollit Shtetëror Portual është i plotësuar me personel del si objektiv kryesor inspektimi i të gjitha anijeve që prekin radat dhe portet e hapura te RSH panvarësisht nga risku që anija paraqet, për të parë nga afër nese këto mjete përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare Detare si dhe kërkesat e Legjislacionit Shqiptar në fushën e detarisë.
- 2) Një nga kërkesat kryesore të IMO është përmirësimi i kushteve të punës dhe jetës së detarëve. Nisur nga ky fakt Sektorit të KSHP i del si objektiv që gjatë kryerjes së inspektimeve një vëmendje të veçantë t'i kushtohet zbatimit të Konventës MLC (Maritime Labour Convention) nga të gjitha Kompanitë e Menaxhimit të anijeve që do të inspektohen.
- 3) Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet mjeteve detare që shërbejnë për transport pasagjerësh dhe mjetesesh. Objektiv i jonë është që të inspektojmë anijet pasagjere të paktën dy here në vit dhe sidomos gjatë zezonit veror, kur është edhe piku, për të parë nga afër kushtet që ofrojnë këto mjete për pasagjerët dhe ekuipazhin e tyre.

## **SYNIMI**

- 1) Nëpërmjet inspektimeve të vazhdueshme ,duke vënë primare profesionalizmin në kryerjen e detyrës, synimi ynë është që të zvogëlohet ndjeshëm numri i anijeve me nivel të lartë risku që prekin portet e hapura të RSH.
- 2) Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe kushteve të punës në zbatim të Konventës MLC
- 3) Parandalimi në kohë i incidenteve dhe aksidenteve dhe mbrojtja e mjedisit detar nga ndotjet e mbetjeve të lengshme dhe të ngurta si dhe nënprodukteve të tyre.

## **P u n o i**

**Përgjegjës I Sektorit të KSHP**

**Kastriot Sali**

